



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.1007/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Goran Milenković – Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “LIMIT L&B “shpk -Prizren, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik VB TOFAJ; INGconcept shpk Qendër –Junik, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Memorialit të Dëshmorëve të Kombit - Belle”, me nr.të prokurimit: 631-20-6723-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Komuna Deçan, më datën: 15.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “LIMIT L&B “shpk -Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i Memorialit të Dëshmorëve të Kombit - Belle”, me nr.të prokurimit: 631-20-6723-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Komuna Deçan.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Memorialit të Dëshmorëve të Kombit - Belle”, me nr.të prokurimit: 631-20-6723-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Komuna Deçan, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “LIMIT L&B” shpk -Prizren, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "LIMIT L&B "shpk -Prizren, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 25.11.2020 me nr. 1007/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Memorialit të Dëshmorëve të Kombit - Belle", me nr.të prokurimit: 631-20-6723-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Komuna Deçan, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit në raportin e dt: 30.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sqarim hyrës: Komuna e Deçan, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është punë, Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër eliminimit të OE ankues.

Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) "LIMIT L&B " sh.p.k

Lidhur me pretendimin e OE ankues "LIMIT L&B " sh.p.k, se AK e ka eliminuar me arsyetimin "...nuk keni plotësuar kërkesat e Kapaciteti teknik dhe professional: dëshminë nr.3 për Menaxherin e projektit - kontrata e punës me ofertuesin (e noterizuar)".

Eksperti shqyrtues sqaron se AK në dosje të tenderit ka kërkuar 9.1 & 9.2 ka kërkuar: pika 3. Menagjeri i Projektit - Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë(baqeller) ose i arkitekturës (baqeller), 2 vite përvojë punë pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy (2) projekte nga lëmia e ngjashme.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

3.CV-a (e nënshkruar nga inxhinieri), - Diploma (e noterizuar), -Kontrata e punës me ofertuesin (e noterizuar).

OE ankues lidhur me këtë kërkesë ka dorëzuar kopjen e kontratës të lidhur nga palët NPN “EUROING”, SHPK (anëtar i grupit me të punësuar i z. Kujtim Thaqi. Pra, kontrata e dorëzuar nga OE ankues përmban nënshkrimin e palëve, vulën, datën. I njëjti sipas certifikatës së regjistrimit të biznesit është pronar dhe drejtor i OE “Euroing” SHPK me numër unik identifikues 811302281 është Kujtim Thaqi. Rrjedhimisht, mos noterizim i të njëjtës kontratë nuk e bënë ofertën e OE ankues si të pa përgjegjshme pasi që përmes certifikatës së biznesit i njëjti është pronar i kompanisë dhe figuron në listën e pagave të punësuarve në ATK etj..

Prove se bashku me raport gjeni kontratën - e ing. z. Kujtim Thaqi

Andaj, duke pasur parasysh kërkesën e AK-së dhe pozicionin ku menaxheri i projektit është pronar dhe drejtor, eksperti shqyrtues vlerëson se ankesa e OE ankues është e bazuar dhe lënda duhet të kthehet në rivlerësim. Përfundimisht, sipas asaj që u përshkrua si me lartë vlerësimi ynë është se AK, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave nuk e ka bërë konform nenit 59, përkatësisht nenit 7, të LPP-së. Prandaj propozimi ynë për AK, është që përmes ri vlerësimit të ofertave ti aplikoi në tërësi dispozitat e LPP-së, në mënyrë që të pasqyrohet gjendja reale e ofertave kundrejt kërkesave të dosjes së tenderit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e dhëna në këtë raport, eksperti shqyrtues i rekomandon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 02.12.2020, me të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, nuk ka përgjigje

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 15.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “LIMIT L&B “ sh.p.k., se AK e ka eliminuar me arsyetimin “..nuk keni plotësuar kërkesat e Kapaciteti teknik dhe profesional: dëshminë nr.3 për Menaxherin e projektit - kontrata e punës me ofertuesin (e noterizuar)”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK në dosje të tenderit ka kërkuar 9.1 & 9.2 ka kërkuar: pika 3. Menagjeri i Projektit - Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë(baqeller) ose i arkitekturës (baqeller), 2 vite përvojë punë pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy (2) projekte nga lëmia e ngjashme.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

3.CV-a (e nënshkruar nga inxhinieri), - Diploma (e noterizuar), -Kontrata e punës me ofertuesin (e noterizuar).

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues lidhur me këtë kërkesë ka dorëzuar kopjen e kontratës të lidhur nga palët NPN "EUROING", SHPK (anëtar i grupit me të punësuarin z. Kujtim Thaqi). Pra, kontrata e dorëzuar nga OE ankues përmban nënshkrimin e palëve, vulën, datën. I njëjti sipas certifikatës së regjistrimit të biznesit është pronar dhe drejtor i OE "Euroing" SHPK me numër unik identifikues 811302281 është Kujtim Thaqi. Rrjedhimisht, mos noterizim i të njëjtës kontratë nuk e bënë ofertën e OE ankues si të pa përgjegjshme pasi që përmes certifikatës së biznesit i njëjti është pronar i kompanisë dhe figuron në listën e pagave të punësuarve në ATK, etj.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimit ankimor, shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se AK, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave nuk e ka bërë konform nenit 59, përkatësisht nenit 7, të LPP-së. Andaj, obligohet AK që përmes ri vlerësimit të ofertave ti aplikoj në tërësi dispozitat e LPP-së, duke bërë ekzaminimin dhe vlerësimin në harmoni me nenin 59 të LPP-së në mënyrë që të pasqyrohet gjendja reale e ofertave kundrejt kërkesave të dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna Deçan;

1x1 OE – "LIMIT L&B" sh.p.k;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.